VENDIM
Nr.23, datë 22.6.1998

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:
Fehmi Abdiu Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Hilmi Dakli Anëtar i " "
Hajredin Fuga Anëtar i " "
Zija Vuçi Anëtar i " "
Franc Jakova Anëtar i " "
Kristofer Peçi Anëtar i " "
Alfred Karamuço, Anëtar i " "
Sokol Sadushi Anëtar i " "
Kujim Puto Anëtar i " "
me sekretare Drita Filto më datë 27.5.1998 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.7 Akti që i përket:
K Ë R K U E S: FRANC PAVACI, i përfaqësuar nga Rrok Sukori dhe avokat Haki Kraja.
SUBJEKT I INTERESUAR: FETAH ADEMI
ENTI I BANESAVE SHKODËR

OBJEKTI:

Deklarimi antikushtetues i Vendimit nr.1880, datë 13.11.1996 të kolegjit civil të Gjykatës së Kasacionit.

Kërkuesi Franc Pavaci paraqet këto shkaqe për deklarimin antikushtetues të vendimit nr.1880, datë 13.11.1996 të Gjykatës së Kasacionit: Gjykata e Kasacionit nuk ka zbatuar Ligjin "Për kthimin e banesave të emigrantëve". Ajo i ka hyrë vlerësimit të çështjes në fakt e ka vendosur rrëzimin e padisë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi shpjegimet e palës kërkuese, subjektit të interesuar dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Kërkuesi Franc Pavaci ka lidhur kontratë qiraje me Ndërmarrjen Komunale Banesa Shkodër në datën 8.12.1989 për një apartament prej dy dhoma e një kuzhinë, por nuk ka banuar në këtë apartament. Pas datës 2 korrik 1990 ai është larguar familjarisht si emigrant në Gjermani. Këshilli pluralist i lagjes duke konstatuar se kjo hyrje nuk përdorej nga kërkuesi, i lëshon autorizim për strehim subjektit të interesuar Fetah Ademi, i cili lidhi kontratë qiraje e më pas kontratë shitblerje.

Kërkuesi ka kërkuar fillimisht në gjykatë konstatimin e pavlefshmërisë së kontratës së qirasë së lidhur midis Fetah Ademit e Ndërmarrjes Komunale Banesa, por kjo padi i është rrëzuar. Pas daljes së ligjit nr.7672, datë 11.02.1993 ai ka kërkuar në gjykatë edhe konstatimin e pavlefshmërisë së kontratës së shitblerjes, padi që i është rrëzuar me vendimin nr.1880, datë 13.11.1996 të Gjykatës së Kasacionit (kolegjit civil).

Gjykata Kushtetuese konstaton se në gjykimin e çështjes së parë, pra për konstatimin e pavlefshmërisë së kontratës së qirasë, nuk kemi cënim të të drejtave themelore, sepse siç dihet qiramarrja e banesave dhe vetë e drejta e banimit nuk parashikohet si e drejtë themelore nga ligji nr.7692, datë 31.3.1993.

Përsa i përket çështjes për konstatimin e pavlefshmërisë së shitblerjes së banesës, kolegji civil i Gjykatës së Kasacionit është bazuar te vendimi i mëparshëm i gjykatës që ka marrë formë të prerë dhe gjykata duke i rrëzuar padinë nuk i ka cënuar ndonjë të drejtë, gjë që mund ta bënte vendimin e saj të papajtueshme me ligjin themelor. Në kuptim të nenit 38 të ligjit nr.7692, datë 31.3.1993 që të deklarohet vendimi i Gjykatës së Kasacionit i papajtueshëm me ligjin themelor duhet të konstatohet që gjatë gjykimit të çështjes të jetë shkelur një nga parimet esenciale për zhvillimin e rregullt të një procesi gjyqësor dhe kjo e lidhur drejtpërsëdrejti me cenimin e së drejtës së pronës.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 24 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me shumicë votash,

VENDOSI:

Rrëzimin e kërkesës.
Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.